


# Indeksi i Çmimeve të Konsumit

**Janar, 2020**

**Tiranë, më 07 Shkurt 2020:** Indeksi i Çmimeve të Konsumit në muajin Janar 2020, arriti 109,1 kundrejt muajit Dhjetor 2015.

Ndryshimi vjetor i indeksit të çmimeve të konsumit në muajin Janar 2020 është 1,5 %. Një vit më parë ky ndryshim ishte 1,9 %. Ndryshimi mujor i indeksit të çmimeve të konsumit në muajin Janar 2020, krahasuar me Dhjetor 2019, është 1,9 %.

**Fig. 1 Ndryshimet vjetore të Indeksit të çmimeve të konsumit (%)**




## **Ndikimi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të indeksit të çmimeve të konsumit.**

Rritja vjetore e çmimeve në muajin Janar është ndikuar kryesisht nga grupi “Ushqime dhe pije joalkoolike” me +0,92 pikë përqindje, pasuar nga grupi “Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji” me +0,31 pikë përqindje. Çmimet e grupit “Transporti” kanë kontribuar me +0,10 pikë përqindje. Çmimet e grupeve “Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë” dhe “Argëtim dhe kulturë” kanë kontribuar +0,07 pikë përqindje secili. Çmimet e grupit “Hotele, kafene dhe restorante” kanë kontribuar me +0,04 pikë përqindje. Çmimet e grupit “Pije alkoolike dhe duhan” kanë kontribuar me +0,02 pikë përqindje. Çmimet e grupeve “Shërbimi arsimor” dhe “Mallra dhe shërbime të ndryshme” kanë kontribuar me +0,01 pikë përqindje secili. Çmimet e grupeve “Veshje dhe këpucë” dhe “Shëndeti” kanë kontribuar me -0,02 pikë përqindje secili. Çmimet e grupit “Komunikimi” kanë kontribuar me -0,01 pikë përqindje.

**Për publikim 07/02/2020**

Fig.2 Ndikimi i grupeve në ndryshimin vjetor



**Ndryshimet vjetore të grupeve kryesore:** Krahasuar me muajin Janar 2019, rritja më e madhe e çmimeve vërehet në grupin “Ushqime dhe pije joalkoolike” me 2,4 %, pasuar nga grupet “Argëtim dhe kulturë” me 2,3 %, “Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji” dhe “Transporti” me 1,5 % secili, “Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë” me 1,2 %, “Hotele, kafene dhe restorante” me 0,9 %, “Pije alkoolike dhe duhan” me 0,5 %, etj. Nga ana tjetër çmimet e grupit “Veshje dhe këpucë” dhe “Shëndeti” u ulën me 0,6 % secili, pasuar nga “Komunikimi” me 0,3 %.

Brenda grupit të ushqimeve çmimet e nëngrupit “fruta” u rritën me 18,2 %, pasuar nga nëngrupet “sheqer, recel, mjaltë, çokollata dhe ëmbëlsira” me 4,3 %, “peshk” me 2,5 %, “qumësht, djathë dhe vezë” me 2,0 %. Nëngrupi “zarzavate përfshirë patatet” u ul me 0,9 %.

**Ndryshimet mujore të grupeve kryesore:** Krahasuar me muajin Dhjetor 2019, çmimet e grupit “Ushqime dhe pije joalkoolike” u rritën me 4,4 %, pasuar nga grupet “Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji” me 1,3 %, “Pije alkoolike dhe duhan” me 0,6 %, “Hotele, kafene dhe restorante” me 0,3 %. Nga ana tjetër çmimet e grupit “Argëtim dhe kulturë” u ulën me 0,5 %, pasuar nga “Shëndeti” dhe “Komunikimi” me 0,2 % secili, etj.

**Tab. 1 Indeksi i Çmimeve të Konsumit**

Dhjetor 2015=100

Kodi	Grupet	Peshat	01-19	02-19	03-19	04-19	05-19	06-19	07-19	08-19	09-19	10-19	11-19	12-19	01-20
	<b>Gjithsej</b>	<b>100</b>	<b>107,6</b>	<b>108,2</b>	<b>107,9</b>	<b>107,6</b>	<b>106,5</b>	<b>106,2</b>	<b>106,1</b>	<b>106,5</b>	<b>106,6</b>	<b>106,4</b>	<b>106,2</b>	<b>107,1</b>	<b>109,1</b>
1	Ushqime dhe pije joalkoolike	37,3	115,7	117,3	116,4	115,5	112,6	111,7	111,3	111,8	112,2	111,7	111,2	113,4	118,4
2	Pije alkoolike dhe duhan	3,4	104,7	104,6	104,7	104,6	104,8	104,8	104,7	104,9	104,9	104,8	104,9	104,6	105,2
3	Veshje dhe këpucë	3,6	100,2	100,1	99,5	99,6	99,0	99,2	98,8	98,5	99,1	99,4	99,6	99,7	99,6
4	Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji	20,9	105,3	105,3	105,1	105,3	105,3	105,1	105,0	105,1	105,1	105,2	105,2	105,4	106,8
5	Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë	6,4	100,1	100,5	100,7	100,7	100,5	100,4	100,4	100,8	100,9	101,0	101,2	101,4	101,3
6	Shëndeti	3,5	99,7	99,8	99,9	100,0	99,9	99,8	99,5	99,5	99,6	99,5	99,4	99,4	99,2
7	Transporti	6,3	101,2	101,2	101,7	101,8	101,6	101,8	102,9	104,5	102,9	102,2	102,1	102,8	102,7
8	Komunikimi	3,0	101,3	101,3	101,3	101,3	101,2	101,2	101,3	101,3	101,2	101,2	101,2	101,2	101,0
9	Argëtim dhe kulturë	2,4	104,3	104,9	105,0	104,4	105,2	105,7	106,4	107,9	108,4	108,0	107,1	107,3	106,8
10	Shërbimi arsimor	2,9	102,1	102,1	102,1	102,1	102,1	102,1	102,1	102,1	102,3	102,3	102,3	102,3	102,3
11	Hotele, kafene dhe restorante	3,9	101,8	101,9	102,0	102,1	102,1	102,3	102,3	102,3	102,4	102,4	102,5	102,5	102,7
12	Mallra dhe shërbime të ndryshme	6,3	103,8	103,7	103,8	103,8	103,6	103,7	103,6	103,7	103,7	103,8	103,8	103,9	103,9

**Tab. 2 Ndryshimet vjetore të Indeksit të Çmimeve të Konsumit**

%

Kodi	Grupet	01-19/01-18	02-19/02-18	03-19/03-18	04-19/04-18	05-19/05-18	06-19/06-18	07-19/07-18	08-19/08-18	09-19/09-18	10-19/10-18	11-19/11-18	12-19/12-18	01-20/01-19
	<b>Gjithsej</b>	<b>1,9</b>	<b>1,7</b>	<b>1,1</b>	<b>1,4</b>	<b>1,5</b>	<b>1,3</b>	<b>1,5</b>	<b>1,4</b>	<b>1,3</b>	<b>1,3</b>	<b>1,4</b>	<b>1,1</b>	<b>1,5</b>
1	Ushqime dhe pije joalkoolike	4,3	3,8	2,0	2,7	3,1	2,7	2,8	2,4	2,5	3,0	3,2	2,6	2,4
2	Pije alkoolike dhe duhan	1,8	1,6	1,0	1,0	1,4	1,4	1,3	1,5	1,5	1,4	1,1	0,2	0,5
3	Veshje dhe këpucë	-0,8	-0,3	0,0	0,3	0,5	0,2	0,2	0,2	0,2	-0,1	-0,3	-0,2	-0,6
4	Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji	0,8	0,9	1,0	1,2	1,1	0,8	0,8	0,8	0,7	0,1	0,1	0,1	1,5
5	Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë	0,1	0,2	0,5	0,7	0,7	0,7	1,3	1,5	1,5	1,4	1,5	1,2	1,2
6	Shëndeti	-0,6	-0,5	-0,4	-0,3	-0,5	0,0	-0,1	-0,1	0,0	-0,1	0,0	-0,4	-0,6
7	Transporti	0,0	0,1	0,5	0,4	-0,1	-0,6	-0,1	1,2	-0,6	-2,0	-1,6	0,2	1,5
8	Komunikimi	0,4	0,1	0,0	0,2	0,2	0,2	0,2	0,1	0,1	0,1	0,0	-0,1	-0,3
9	Argëtim dhe kulturë	1,8	2,1	1,1	-1,1	-0,6	-0,1	1,1	2,2	0,5	1,2	2,1	2,2	2,3
10	Shërbimi arsimor	0,7	0,7	0,7	0,7	0,7	0,7	0,7	0,8	0,9	0,2	0,2	0,2	0,2
11	Hotele, kafene dhe restorante	1,1	1,1	1,2	1,1	1,1	1,3	1,1	1,1	1,2	1,2	1,3	0,6	0,9
12	Mallra dhe shërbime të ndryshme	0,2	0,1	0,1	0,0	0,0	0,0	0,1	0,1	0,2	0,3	0,2	0,2	0,1

**Tab. 3 Ndryshimet mujore të Indeksit të Çmimeve të Konsumit**

%

Kodi	Grupet	01-19	02-19	03-19	04-19	05-19	06-19	07-19	08-19	09-19	10-19	11-19	12-19	01-20
	<b>Gjithsej</b>	<b>1,6</b>	<b>0,6</b>	<b>-0,3</b>	<b>-0,2</b>	<b>-1,0</b>	<b>-0,3</b>	<b>-0,1</b>	<b>0,3</b>	<b>0,1</b>	<b>-0,2</b>	<b>-0,1</b>	<b>0,8</b>	<b>1,9</b>
1	Ushqime dhe pije joalkoolike	4,6	1,4	-0,8	-0,7	-2,6	-0,7	-0,4	0,4	0,4	-0,5	-0,4	2,0	4,4
2	Pije alkoolike dhe duhan	0,3	-0,1	0,1	0,0	0,1	0,0	-0,1	0,2	0,0	-0,1	0,0	-0,2	0,6
3	Veshje dhe këpucë	0,2	-0,1	-0,6	0,0	-0,6	0,2	-0,4	-0,2	0,6	0,4	0,1	0,1	-0,1
4	Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji	0,0	0,0	-0,2	0,2	-0,1	-0,2	-0,1	0,1	0,0	0,1	0,0	0,2	1,3
5	Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë	-0,1	0,4	0,2	0,0	-0,1	-0,1	0,0	0,4	0,1	0,0	0,2	0,2	-0,1
6	Shëndeti	0,0	0,0	0,1	0,1	-0,1	-0,1	-0,4	0,0	0,1	-0,1	-0,1	0,0	-0,2
7	Transporti	-1,4	0,0	0,5	0,0	-0,1	0,2	1,0	1,6	-1,5	-0,7	-0,1	0,6	0,0
8	Komunikimi	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	-0,2
9	Argëtim dhe kulturë	-0,6	0,6	0,1	-0,6	0,7	0,5	0,6	1,5	0,4	-0,3	-0,8	0,2	-0,5
10	Shërbimi arsimor	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,2	0,0	0,0	0,0	0,0
11	Hotele, kafene dhe restorante	0,0	0,1	0,1	0,1	0,0	0,2	0,0	0,0	0,1	0,0	0,1	0,0	0,3
12	Mallra dhe shërbime të ndryshme	0,1	0,0	0,0	0,0	-0,2	0,1	-0,1	0,0	0,0	0,1	-0,1	0,1	0,0

# Metodologjia

## Ndryshime metodologjike

Në muajin Janar të çdo viti Indeksi i Çmimeve të Konsumit shoqërohet me disa ndryshime metodologjike sipas metodologjisë ndërkombëtare të llogaritjes së këtij treguesi, të cilat konsistojnë në:

- Përditësimin e peshave: Peshat e mallrave dhe shërbimeve janë ndryshuar duke u bazuar në shpenzimet mesatare të Anketës së Buxhetit të Familjeve 2018,
- Përditësimin e listës së mallrave dhe shërbimeve: Shporta përbëhet nga 331 produkte dhe shërbime,
- Përditësimin e listës së njësive tregtare ku mbliidhen çmimet,

## Përkufizime

**Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK)** është matësi zyrtar i inflacionit në Shqipëri, Indeksi mat ndryshimet relative të çmimeve të mallrave dhe shërbimeve të përdorura nga familjet për konsum vetjak dhe llogaritet duke përdorur strukturën e konsumit final të familjeve shqiptare, Burimi kryesor i informacionit për shpenzimet është Anketa e Buxhetit të Familjeve,

**Ndryshimi vjetor** mat ndryshimin e indeksit të çmimeve midis muajit korrent me të njëjtin muaj të vitit të mëparshëm, Ky ndryshim është rrjedhojë e ndryshimeve korente në nivelin e çmimeve, por mund të ndikohet edhe nga efektet e papërsëritshme të cilitdo muaj,

**Ndryshimi mujor** mat ndryshimin e indeksit të çmimeve të muajit korrent me muajin e mëparshëm, Ky tregues është i ndjeshëm nga efektet sezonale,

**Ndryshimi mesatar 12 mujor** mat ndryshimin e indeksit mesatar të konsumit në 12 muajt e fundit me indeksin mesatar të 12 muajve të mëparshëm,